STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 29 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON VEPRIME TE REJA PER TE PERSHPEJTUAR PRETENDIMET E SIGURIMIT TE LIDHURA ME SENDIN (SANDY) DHE NIS SISTEMIN E KARTES SE RAPORTIMIT NE INTERNET PER NDERMARRJET E SIGURIMIT

DFS do të botojë kartat e raportimit në internet që japin me hollësi funksionimin e secilës ndërmarrje të sigurimeve

Rregullat e reja do të shkurtojnë në mënyrë të konsiderueshme kohën e lejuar për të hetuar pretendimet dhe do të vendosin më shumë inspektorë në terren për të ndihmuar pronarët e shtëpive

Pas takimit me zyrtarë të lartë të ndërmarrjeve të sigurimeve këtë javë, Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi një sërë masash për të përshpejtuar pagesën e pretendimeve për banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) të prekur nga Uragani Sendi (Sandy) dhe nisi një sistem të ri të kartës së raportimit në internet, www.NYInsure.ny.gov, për t'i mbajtur ndërmarrjet e sigurimeve të përgjegjëshme.

Sipas udhëzimit të Guvernatorit, Departamenti i Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) (DFS) nxorri një rregullore të re që do të shkurtojë me më shumë se gjysmën kohën që siguruesit kanë për të dërguar inspektorët në shtëpitë dhe bizneset për të kontrolluar pretendimet, duke ndihmuar kështu që konsumatorët të marrin pagaset e tyre më shpejt. Përveç kësaj, Guvernatori Kuomo (Cuomo) nënshkroi një urdhër ekzekutiv që do të lejojë dhënien e përshpejtuar të liçensave të përkohëshme për inspektorë të kualifikuar të sigurimeve publike nga jashtë shtetit, duke rritur numrin e inspektorëve në dispozicion të konsumatorëve të Nju Jorkut (New York) për të ndihmuar të marrjen e zgjidhjeve të pretendimeve të tyre me shpejt. Së fundmi, sipas udhëzimit të Guvernatorit, DFS do të botojë karta të raportimit që vlerësojnë funksionimin e ndërmarrjeve të sigurimit duke reaguar ndaj katastrofës dhe në pagimin e pretendimeve. Kartat e raportimit do të botohen në një faqe të re në internet, www.NYInsure.ny.gov, që Guvernatori e nisi sot. Faqja në internet do të azhornohet rregullisht.

"Pas Uraganit Sendi (Sandy), është jetike që banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) të marrin zgjidhjet e pretendimeve të tyre sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që të mund të rindërtojnë shtëpitë,

bizneset dhe jetën e tyre," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Thjesht nuk ka asnjë zëvendësim të shpejtësisë kur bëhet fjalë për pagesat e sigurimeve pas një stuhie. Duhet të bëjmë gjithshka që është e mundur për t'u siguruar se i mbajmë ndërmarrjet e sigurimeve të përgjegjëshme ndaj konsumatorëve të tyre. Veprimet e sotme bëjnë pikërisht atë."

Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky), Kryeinspektor i Shërbimeve Financiare, tha, "Funksionimi i ndërmarrjeve të sigurimit pas një stuhie si Sendi (Sandy) është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Pronarët e shtëpive dhe bizneseve kanë të drejtën të dinë sesi janë duke funksionuar siguruesit e tyre dhe sa shpejt ndërmarrjet janë duke trajtuar pretendimet."

Guvernatori Kuomo (Cuomo) gjithashtu njoftoi sot se, sipas udhëzimit të tij, Kryeinspektori i DFS-së Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky) do të vazhdojë ndalimin që nuk lejon që ndërmarrjet e sigurimeve të anullojnë ose t'u japin fund policave të sigurimit të pronarëve të shtëpive dhe pronarëve të bizneseve të vogla në rajonet e goditura nga stuhia për çdo arsye, përfshirë mospagesën e premiumeve për 21 ditë të tjera deri më 15 dhjetor.

Ky urdhër ekzekutiv dhe ndalim zbatohet për banorët dhe pronarët e bizneseve në qarqet Bronks (Bronx), Kings (Kings), Naso (Nassau), Nju Jork (New York), Oranxh (Orange), Kuins (Queens), Riçmond (Richmond), Roklënd (Rockland), Safolk (Suffolk) dhe Uestçestër (Westchester).

Urdhëri i Guvernatorit gjithashtu zgjat kohën kur Kryeinspektori mund të mospranojë kërkesat e bankierëve të liçensuar të hipotekave ose ndërmjetësve të rregjistruar të hipotekave që të hapin zyra të degëve dhe përkohësisht pezullon një kusht të domosdoshëm që përfshin investimet për zhvillimin e komunitetit.

Nis sistemi i kartave të raportimit në internet të ndërmarrjeve të sigurimeve

Sipas udhëzimit të Guvernatorit, Kryeinspektori i DFS-së Loski (Lawsky) nisi një sistem të kartave të raportimit në internet në lidhje me ndërmarrjet e sigurimeve që janë duke funksionuar në rajonet që u prekën nga Uragani Sendi (Sandy) Ky veprim do t'i mbajë ndërmarrjet e sigurimeve të përgjegjëshme ndaj konsumatorëve dhe do të lejojë banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) të shohin funksionimin e ndërmarrjes së tyre të sigurimeve në krahasim me ndërmarrjet e tjera. Kartat e raportimeve do të botohen në faqen në internet të DFS-së dhe do të azhornohen shpesh. Ato do të jenë të disponueshme sot në www.NYInsure.ny.gov.

Ndërmjet kritereve të tjera, ndërmarrjet e sigurimeve do të vlerësohen për:

- Numrin e pretendimeve dhe sasinë në dollarë të pretendimeve
- Kohën mesatare që një inspektor të kontrollojë

- Numrin e pretendimeve të zgjidhura me dhe pa pagesë deri tani
- Sasinë e pretendimeve të paguara deri tani
- Numrin gjithsej të ankesave të konsumatorëve
- Numrin e ankesave si një përqindje e numrit të pretendimeve

DFS do të botojë kartat e raportimit për ndërmarrjet e mëposhtme:

- Nationwide
- Liberty Mutual
- Hartford
- FM Global
- Allstate
- Chartis/AIG
- State Farm
- USAA
- Utica National
- Zurich
- Metropolitan
- Narraganset Bay Insurance Company
- QBE
- Arch
- New York Central Mutual
- Amtrust Financial

- Travelers
- Tower
- Adirondack Insurance Exchange
- Chubb
- GEICO
- Andover
- Assurant
- NYPIUA

Rregullorja e re të përshpejtojë afatin kohor për hetimin e pretendimit

Rregullorja e re e nxjerrë nga Guvernatori Kuomo (Cuomo) do të shkurtojë afatin kohor në të cilin siguruesit duhet të dërgojnë një inspektor për të kontrolluar një pretendim. Ky veprim do të ndihmojë që ndërmarrjet e sigurimeve t'i përpunojnë pretendimet më shpejt dhe të paguajnë pretendimet për konsumatorët më shpejt. Duke filluar që sot, rregullorja e re do t'u kërkojë ndërmarrjeve të sigurimeve që të fillojnë hetimin e pretendimeve brenda gjashtë ditëve të biznesit pasi pretendimi është bërë tek siguruesi, sesa 15 ditë të biznesit sipas rregullave të tanishme. Rregulli i ri zbatohet për Stuhinë Sendi (Sandy). Përveç kësaj, rregullorja e bën të qartë se për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë, me përjashtim të policave të nxjerra sipas programit kombëtar të sigurimit të përmbytjeve, pretenduesit mund të fillojnë riparime të menjëhershme të sistemeve të ngrohjes, sistemeve të ujit të ngrohtë dhe lidhjeve elektrike të nevojshme, si dhe dritaret e jashtme, dyert e jashtme dhe, për riparime të përherëshme të vogla, mure të jashtme, në mënyrë që të bëjnë të mundur që pronat të ruajnë nxehtësinë.

Urdhëri ekzekutiv për të përshpejtuar pretendimet

Urdhëri ekzekutiv i Guvernatorit do të autorizojë që inspektorë të kualifikuar publikë nga jashtë shtetit, puna e të cilëve është të këshillojnë për llogari të pronarëve të shtëpive, të marrin liçensa të përkohëshme për të punuar në shtet. Tashmë ka më shumë se 16,800 inspektorë nga jashtë shtetit që kanë marë liçensa të përkohëshme për të punuar për llogari të ndërmarrjeve të sigurimeve, gjë që më shumë se dyfishon sasinë e inspektorëve që punojnë për siguruesit në Shtetin e Nju Jorkut (New York State). DFS ka lejuar që më shumë inspektorë të sigurimeve të funksionojnë në shtet në mënyrë që ndërmarrjet e sigurimeve të jenë në gjendje që të vlerësojnë dhe të paguajnë pretendimet në një

mënyrë më të shpejtë dhe të ndihmojnë që banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) të prekur nga Uragani Sendi (Sandy) të rindërtojnë.

Urdhëri i ri do të lejojë liçensimin e inspektorëve të përkohëshëm publikë, që punojnë për llogari të një mbajtësi të policës që të diskutojë mbi një zgjidhje të pretendimeve për llogari të konsumatorit.

Për t'u kualifikuar, inspektorët publikë nga jashtë shtetit duhet:

- Të bëjnë kërkesë për një liçensë të përkohëshme në DFS
- Të kenë një liçensë të vlefshme të sigurimit që nuk u është hequr gjatë 10 viteve të fundit
- Të mos jenë shpallur fajtor ose të mos kenë pranuar fajësinë për ndonjë krim në SHBA gjatë 10 viteve të fundit
- Të mos jenë akuzuar për mashtrim ose sjellje jo-etike në SHBA gjatë 10 viteve të fundit

Më poshtë është urdhëri i plotë Ekzekutiv:

Nr. 82

U R D H E R E K Z E K U T I V

PEZULLIMI I PERKOHESHEM DHE MODIFIKIMI I DISPOZITAVE TE LIGJIT MBI SIGURIMIN

NDERSA, më 26 tetor 2012 nxorra Urdhërin Ekzekutiv Numër 47, duke shpallur një emergjencë prej katastrofës në të gjitha 62 qarqet në Shtetin e Nju Jorkut (State of New York); dhe

NDERSA, më 30 tetor 2012, Presidenti nxorri një deklaratë të katastrofës së rëndë për qarqet Bronks (Bronx), Kings (Kings), Naso (Nassau), Nju Jork (New York), Kuins (Queens), Riçmond (Richmond) dhe Safolk (Suffolk), më 2 nëntor e zgjeroi një deklaratë të tillë për të përfshirë qarqet Roklënd (Rockland) dhe Uestçestër (Westchester) dhe më pas e zgjeroi një deklaratë të tillë për të përfshirë Qarkun Oranxh (Orange); dhe

NDERSA, Uragani Sendi (Sandy) solli erëra dëmtuese dhe rrjedhje shiu me rrebesh duke shkaktuar përmbyje rekord dhe vërshime të rënda të stuhisë anembanë Shtetit të Nju Jorkut (State of New York) që shkatërruan rëndë Shtetin; dhe

NDERSA, stuhia shkaktoi dëm të përhapur gjerë ndaj pronave anembanë në qarqet e prekura, duke krijuar një nevojë thelbësore që inspektorët e sigurimeve të shohin dhe të vlerësojnë një dëm të tillë për të siguruar se pretendimet për sigurimin e pasurisë/viktimave të konsumatorëve janë përpunuar në kohë;

TANI, PRANDAJ, une, ENDRJU M. KUOMO (ANDREW M. CUOMO), Guvernator i Shtetit të Nju Jorkut (State of New York), nëpërmjet autoritetit që më është dhënë nga Pjesa 29-a e Nenit 2-B të Ligjit Ekzekutiv për të pezulluar ose modifikuar përkohësisht dispozitat e caktuara të çdo statuti, ligji vendor, urdhërese, urdhëri, rregulla ose rregullore ose pjesë të tyre, të çdo agjencie gjatë një emergjence të katastrofës në shtet, nëse veprimi në përputhje me dispozita të tilla do të parandalojë, pengojë ose vonojë veprimin e nevojshëm për të përballuar katastrofën, këtu pezulloj ose modifikoj përkohësisht, sipas rastit, për periudhën nga data e këtij Urdhëri Ekzekutiv deri në një njoftim të mëtejshëm, sa më poshtë:

Pjesën 2108 të Ligjit mbi Sigurimin, së bashku me çdo rregullore që ka lidhje me të, deri në masën që kërkojnë liçensimin e përherëshëm të inspektorëve publikë nga Departamenti i Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) ("Departamenti") në mënyrë që, për qëllimet e vetëm këtij Urdhëri Ekzekutiv, Departamenti të mund të japë liçensa të përkohëshme të inspektorëve publike që autorizojnë të liçensuar të tillë të përkohëshëm që të rregullojnë pretendimet për sigurimin e pasurisë/viktimave në qarqet Bronks (Bronx), Kings (Kings), Naso (Nassau), Nju Jork (New York), Oranxh (Orange), Kuins (Queens), Riçmond (Richmond), Roklënd (Rockland), Safolk (Suffolk) dhe Uestçestër (Westchester) që kanë filluar gjatë periudhës për të cilën ky Urdhër Ekzekutiv është në fuqi, për sa kohë që: (1) një kërkesë për një liçensë të përkohëshme bazuar në këtë urdhër është bërë në një formular të parashikuar nga Kryeinspektori i Shërbimeve Financiare; (2) një formular i tillë është nënshkruar nga një inspektor publik që është i liçensuar në këtë shtet bazuar në Pjesën 2108 të Ligjit mbi Sigurimin; liçensa e të cilit është në një gjendje të mire; dhe i cili do të jetë përgjegjës si për mbikqyrjen e të liçensuarit të përkohëshëm ose në një marrëdhënie punësues/punonjës ose një marrëveshje tjetër ku inspektori i liçensuar publik ka kontroll mbi të liçensuarin e përkohëshem dhe mbi përfundimin e kënaqshëm të të gjitha kontrolleve të mara përsipër nga i liçensuari i përkohëshëm; (3) i liçensuari i përkohëshëm nuk ka patur një liçensë të sigurimeve të hequr, të pezulluar ose përndryshe të përfunduar me arsye në ndonjë shtet në Shtetet e Bashkuara gjatë dhjetë viteve të fundit; (4) i liçensuari i përkohëshëm nuk është akuzuar për, shpallur fajtor për ose ka pranuar fajësinë pa kundërshtuar në lidhje me një krim ose kundravajtje në ndonjë shtet në Shtetet e Bashkuara gjatë dhjetë viteve të fundit; (5) i liçensuari i përkohëshëm nuk është shpallur përgjegjës për keqinterpretim, mashtrim ose sjellje jo-etike në ndonjë shtet në Shtetet e Bashkuara gjatë dhjetë viteve të kaluara; dhe (6) i liçensuari i përkohëshem tashmë është i liçensuar në një shtet tjetër si një inspektor publik ose i pavarur për të rregulluar pretendime për sigurimin e pasurisë/viktimave; ose ka 5 vjet përvojë të mëparshme brenda dhjetë viteve të fundit si një inspektor publik ose i pavarur që rregullon pretendime për sigurimin e pasurisë/viktimave në Shtetet e Bashkuara; ose është liçensuar si një inspektor publik ose i pavarur në Shtetin e Nju Jorkut (New York State) brenda 5 viteve të fundit.

D H E N E me dorën time dhe me Vulën e Shtetit (Privy Seal of the State) në Qytetin Albani (City of Albany) këtë ditë të njëzet e nëntë të nëntorit në vitin dy mijë e dymbëdhjetë.

NGA GUVERNATORI

Sekretarja e Guvernatorit

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian